

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

NDËRMJETËSIM I PASURIVE
TË PALUAJTSHME

(2 vjeçar)

Niveli V i KSHK
(Pas të mesmes)

Kodi: L1-V-22

Miratoi:

MINISTRI

.....

Hartuar me mbështetjen e Projektit “Skills for Jobs”

Tiranë, 2022

Përmbajtja:

- I. Qëllimet e arsimit profesional pas të mesmes në profilin “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”, niveli V i KSHK**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”, niveli V i KSHK.**
 - 1.Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”, niveli V i KSHK
 - 2.Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”, niveli V i KSHK
 - 3.Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në profilin “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”, niveli V i KSHK
- III. Plani mësimor për profilin “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”, niveli V i KSHK**
- IV. Udhëzime për planin mësimor**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin, provimet dhe certifikatën.**
- VII. Përshkruesit e moduleve profesionale.**
- VIII. Programi i përgjithshëm i praktikave profesionale në biznes**

I. Qëllimet e arsimit profesional pas të mesmes në profilin “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”, niveli V i KSHK

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”, niveli V i KSHK është *“zhvillimi i personalitetit të individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për të ofruar këshillim, negociim dhe ndërmjetësim me qëllim realizimin e transaksioneve që kanë për objekt pasuritë e paluajtshme, si dhe për krijimin e menaxhimin e një biznesi privat në këtë fushë, si person fizik ose juridik”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale në nivelin pas të mesëm, u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse dhe krijuese, si dhe vlerat artistike dhe morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar nga pikëpamja artistike, psikologjike dhe fizike, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”, niveli V i KSHK

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional, në profilin “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”, niveli V i KSHK

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”, niveli V i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë ato/ata:

- Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm, të përgjithshëm ose profesional, në nivelin IV të KSHK;
- Individë që janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- Individë që kanë aftësi të kufizuara, për të cilët institucioni arsimor krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”, niveli V i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”, niveli V i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale

si më poshtë:

- Të komunikojë me etikë profesionale.
- Të zbatojë legjislacionin shqiptar për aspekte të ndryshme në fushën e ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme.
- Të planifikojë dhe organizojë veprimtaritë në kuadrin e ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme.
- Të kërkojë në treg për pasuri të paluajtshme dhe klientë.
- Të analizojë tregun e pasurive të paluajtshme dhe klientët
- Të interpretojë dokumentacionin teknik urbanistik dhe ndërtimor.
- Të zbatojë metodologjinë e përshtatshme të vlerësimit të pasurisë së paluajtshme.
- Të analizojë aspektet e efijencës energjitike të pasurisë së paluajtshme.
- Të realizojë veprimtaritë e marketingut tradicional dhe dixhital.
- Të zbatojë procedurat e ndërmjetësimit të transaksionit dhe të shërbimeve të lidhura me të.
- Të përgatitë kontrata në lidhje me transaksionet e pasurive të paluajtshme.
- Të këshillojë klientët për aspekte të ndryshme që kanë të bëjnë me transaksionet e pasurive të paluajtshme.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në ndërmjetësimin e pasurive të paluajtshme.
- Të përdorë teknologjinë dixhitale për qëllime profesionale.

3. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimimit në profilin mësimor “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”, niveli V i KSHK.

Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme” në nivelin V të KSHK, e pajis nxënësin me certifikatën e “ndërmjetësuesit të pasurive të paluajtshme”.

Ky kualifikim profesional i jep individit mundësi t'i drejtohet tregut të punës si konsulent i pasurive të paluajtshme, ndërmjetësues për pasuri të paluajtshme, agjent i pasurive të paluajtshme, agjent shitjesh i pasurive të paluajtshme, menaxher i zyrës imobiliare, broker, investitor në pasuritë e paluajtshme, menaxher i pasurive të paluajtshme, në pozicione të lidhura me dhënien e ekspertizës për pasuri të paluajtshme, si dhe të krijojë një biznesi privat, si person fizik ose juridik.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”, niveli V i KSHK.

Plani mësimor për profilin mësimor “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”, niveli V i KSHK (2 vjeçar)				
Nr	Kodi	Modulet mësimore	Javët/orët vjetore	
			Viti I	Viti II
			25/750	25/750
1	M-17-1861-22	Hyrje në ndërmjetësimin e pasurive të paluajtshme	50	-
2	M-17-1862-22	Aftësitë sipërmarrëse të ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme.	100	-

3	M-17-1863-22	Etika profesionale dhe komunikimi	100	-
4	M-17-1864-22	Aspektet juridike te pronësisë dhe kalimit të të drejtave reale të saj.	125	-
5	M-17-1865-22	Prospektimi, rëndësia dhe metodologjia e tij.	100	-
6	M-17-1866-22	Marketingu në fushën e ndërmjetësimit	75	-
7	M-17-1867-22	Ndërmjetësimi dhe shitja	200	-
8	M-17-1868-22	Përdorimi i TIK në ndërmjetësimin e pasurive të paluajtshme	-	125
9	M-17-1869-22	Kërkimi dhe analiza e tregut në fushën e ndërmjetësimit.	-	175
10	M-17-1870-22	Zhvillimi urban dhe teknika e ndërtimit	-	150
11	M-17-1871-22	Vlerësimi financiar i pasurisë së paluajtshme	-	175
12	M-17-1872-22	Investimi në pasuritë e paluajtshme	-	125
13	Praktikë profesionale në biznes		4/200	4/200
Gjithsej			29/950	29/950

IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor në arsimin profesional për “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme” në nivelin V të KSHK, pas të mesmes, zgjat 2 vite mësimore me kohëzgjatje të përgjithshme prej **1900 orësh mësimore**, me këtë ndarje:

Viti I: 29 javë – 950 orë mësimore

- Mësim teoriko-praktik: 25 javë mësimore x 5 ditë/javë x 6 orë mësimore/ditë = 750 orë mësimore.
- Praktikë profesionale e grupuar në biznes: 4 javë x 5 ditë/javë x 10 orë mësimore/ditë = 200 orë mësimore

Viti II: 31 javë – 950 orë mësimore

- Mësim teoriko-praktik: 25 javë mësimore x 5 ditë/javë x 6 orë mësimore/ditë = 750 orë mësimore.
- Praktikë profesionale e grupuar në biznes: 4 javë x 5 ditë/javë x 10 orë mësimore/ditë = 200 orë mësimore
- Provimet përfundimtare teorike dhe praktike: 2 javë

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”, niveli V i KSHK, përbëhet nga përshkruesit e Moduleve profesionale teoriko-praktike, si dhe programi i Praktikës profesionale në biznes, Një javë mësimore në shkollë = 5 ditë/javë x 6 orë mësimore/ditë = 30 orë mësimore. Një orë mësimore zgjat 45 minuta. Gjatë praktikës profesionale në biznes, 8 orë (60 minutëshe) praktikë janë të barasvlefshme me 10 orë mësimore 45 minutëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

A. Udhëzime për realizimin e procesit mësimor teoriko-praktik në shkollë.

Rekomandohet që modulet profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe. Renditja e realizimit të moduleve profesionale bëhet nga vetë shkolla, duke konsideruar parimet didaktike bazë (nga më e thjeshta te më e ndërlikuara, nga niveli i ulët te më i larti, nga teoria te praktika etj.), si dhe kushtet konkrete të shkollës. Për të rritur eficiencën e

procesit mësimor, mund të realizohen paralelisht dy ose më shumë module, si dhe mund të zbatohet ndarja në grupe e nxënësve.

Mësuesit e moduleve profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënëit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin tek ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e moduleve profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të teorisë me praktikën në to, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënëit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”, niveli V i KSHK.

Mësuesit duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës dhe punës. *Puna në grup* dhe *Puna me detyra (projekte)* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimin (teorik dhe praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit është fakti që *të nxënëit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve dhe praktika në biznes, kanë një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilitin profesional “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”, niveli V i KSHK.

B. Udhëzime për realizimin e praktikës profesionale në biznes.

Realizimin e praktikës profesionale në biznes duhet të krijojë mundësi për një zbatim të kompetencave në realitetin profesional të ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme. Biznesi duhet të caktojë personin përgjegjës (instruktorin e biznesit) për mbështetjen e nxënësve në realizimin e programit të praktikës, në bashkëpunim me mësuesin e shkollës, si dhe gjatë kohës kur ky i fundit nuk është prezent gjatë kësaj praktike. Shkolla duhet të informojë biznesin për numrin e nxënësve që do të kryejnë praktikën në këtë biznes, periudhën kohore, programin e praktikës dhe programin mësimor që kanë kryer më parë në shkollë.

Rekomandohet që Praktika profesionale në biznes të kryhet në blloqe javore, duke konsideruar edhe mundësitë e bizneseve.

Planifikimi i realizimit të praktikës në biznes duhet të bazohet në një proces analize fillestare duke marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, programi i përgjithshëm i praktikës në biznes, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja mësimore e realizuar më parë në shkollë, objektivat konkretë që do të arrihen në biznes, mundësitë dhe kushtet e biznesit për realizimin e praktikës së nxënësve etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i koordinatorit të marrëdhënieve me biznesin, personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës si dhe i përfaqësuesve të biznesit.

Shkolla është e detyruar që, nëpërmjet mësimdhënësit të shkollës, përgjegjës për praktikën profesionale në biznes, të mbikëqyrë dhe mbështesë realizimin e programit, bazuar në kontratat dhe marrëveshjet paraprake.

Programi i detajuar i realizimit të praktikës profesionale në biznes, raportet e ecurisë së praktikës, shkalla e përmbushjes së programit si dhe fletët e vlerësimit të nxënësve duhet të jenë pjesë e dokumentacionit për realizimin e kësaj praktike në biznes.

Instruktori i biznesit, në bashkëpunim me mësuesin e shkollës, duhet të përfshijë, motivojë, mbikëqyrë dhe vlerësojë nxënësit në të gjitha veprimtaritë e parashikuara në program. Dhënia e përgjegjësisë në vendin e punës, puna e mbikëqyrur dhe pavarur duhet të jenë pjesë e realizimit të programit.

Nxënësi duhet të dokumentojë në portofolin e tij të gjitha përvojat dhe rezultatet nga praktika profesionale në biznes, të përgatitë një raport dhe ta prezantojë në klasë, si pjesë e këtij portofoli.

VI. Udhëzime për vlerësimin, provimet dhe certifikatën.

Vlerësimi vjetor i nxënësve për modulet profesionale bëhet nga vetë mësuesit përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4 ÷ 10) për modulet teoriko-praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare. Edhe gjatë praktikës profesionale në biznes, vlerësimi i nxënësve bëhet me nota nga mësuesi i shkollës, në bashkëpunim të ngushtë me instruktorin e biznesit.

Në përfundim të arsimimit pas të mesëm për “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”, niveli V i KSHK, nxënësit i nënshtrohen provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi teorik profesional (test me shkrim)
- b) Provimi praktik profesional (realizimi i një detyre/projekti praktik, individual ose në grup).

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale të profilit “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”.

Me përfundimin e sukseshëm të shkollimit, nxënësit marrin Certifikatën e aftësisimit profesional, e cila njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, kjo dëshmi përmban:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar etj.
- b) Të dhëna për rezultatet (notat) e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në modulet profesionale;
 - rezultatet e dy provimeve përfundimtare.

VII. Përshkruesit e moduleve profesionale

1. Moduli “Hyrje në ndërmjetësimin e pasurive të paluajtshme”

Profili: Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme

Niveli: V i KSHK

Viti: I

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË NDËRMJETËSIMIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME	M-17-1861-22
Qëllimi i modulit	Një modul teorik që i njeh nxënësit me nocionet “pasuri e paluajtshme”, “ndërmjetësim”, “ndërmjetësues”, me rëndësinë e sektorit të pasurive paluajtshme në ekonominë e një vendi, si dhe karakteristikat e ndërmjetësuesit të pasurive të paluajtshme.	
Kohëzgjatja e modulit	50 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të përgjithshëm ose profesional.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi përshkruan nocionet “pasuri e paluajtshme”, “ndërmjetësim” dhe “ndërmjetësues”.</p> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përshkruajë nocionin e pasurisë së paluajtshme;- të përshkruajë llojet e pasurive të paluajtshme;- të përshkruajë karakteristikat e përgjithshme të pasurive të paluajtshme;- të përshkruajë transaksionet që kryhen me pasuritë e paluajtshme;- të përshkruajë nocionin ndërmjetësim dhe ndërmjetësues;- të tregojë procedurat për kryerjen e një ndërmjetësimi;- të tregojë format e ndërmjetësimit;- të dallojë llojet e dokumentacionieve që përdoren gjatë ndërmjetësimit;- të dallojë format dhe mënyrat e ruajtjes së dokumentacioneve. <p>Instrumentat e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje - përgjigje me gojë dhe me shkrim.- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>RN 2 Nxënësi përshkruan karakteristikat e ndërmjetësuesit të pasurive të paluajtshme.</p> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përshkruajë detyrat kryesore (veprimtarinë) të	

- ndërmjetësuesit të pasurisë së paluajtshme;
- të përshkruajë kriteret profesionale për ndërmjetësuesin e pasurisë së paluajtshme;
- të përshkruajë mjedisin, mjetet dhe kushtet e punës së ndërmjetësuesit të pasurisë së paluajtshme;
- të përgatitë si duhet vendin e punës;
- të tregojë mundësitë e punësimit të ndërmjetësuesit të pasurisë së paluajtshme;
- të përshkruajë kërkesat ligjore për liçensimin dhe për ushtrimin e profesionit të ndërmjetësuesit të pasurisë së paluajtshme.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi përshkruan rëndësinë e sektorit të pasurive paluajtshme në ekonominë e një vendi.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë tregun e pasurive të paluajtshme;
- të tregojë rëndësinë e njohjes së tregut të pasurive të paluajtshme dhe dinamikën e tij;
- të përshkruajë zhvillimin historik të këtij tregu, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- të përshkruajë format e realizimit të veprimtarisë së këtij tregu (franchise, etj.);
- të argumentojë rëndësinë që ka për ekonominë e një vendi sektori i pasurive të paluajtshme;
- të shpjegojë rëndësinë e ndërmjetësimit në sektorin e pasurive të paluajtshme;
- të përshkruajë sfidat dhe perspektivën e sektorit të pasurive të paluajtshme.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të zhvillohet në klasë.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore.
- Nxënësit (kursantët) duhet të angazhohen në studim individual të çështjeve teorike që trajtohen në modul si dhe në diskutime në grup në lidhje me nocionet “pasuri e paluajtshme”, “ndërmjetësim”, “ndërmjetësues”, me rëndësinë e sektorit të pasurive paluajtshme në ekonominë e një vendi, si dhe karakteristikat e ndërmjetësuesit të pasurive të paluajtshme.
- Mësuesi duhet të japë detyra individuale dhe në grup për të studiuar dhe analizuar karakteristika të ndërmjetësuesit të pasurisë së paluajtshme.
- Nxënësit (kursantët) duhet të angazhohen sa më shumë të jetë e

mundur në diskutimet në lidhje me nocionet “pasuri e paluajtshme”, “ndërmjetësim”, “ndërmjetësues”, me rëndësinë e sektorit të pasurive paluajtshme në ekonominë e një vendi, si dhe karakteristikat e ndërmjetësuesit të pasurive të paluajtshme.

- Mësuesi duhet të organizojë vizita në mjedise pune reale.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve / kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të nxëni.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin e mësimin, të pajisur si më poshtë:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Kompjuter dhe projektor.
 - Materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli “Aftësitë sipërmarrëse të ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”

Profili: Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme

Niveli: V i KSHK

Viti: I

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	AFTËSITË SIPËRMARRËSE TË NDËRMJETËSIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME	M-17-1862-22
Qëllimi i modulit	Një modul teorik-praktik që i njeh nxënësit me aftësitë sipërmarrëse të ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme, rolin dhe rëndësinë e sipërmarrjes, konceptet e përgjithshme të tregut, themelimin dhe organizimin e biznesit të ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme, si dhe ndërtimin e karrierës dhe performancës së duhur.	
Kohëzgjatja e modulit	100 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të përgjithshëm ose profesional.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi përshkruan kuptimin, rolin dhe rëndësinë e sipërmarrjes, si dhe edukimit të karrierës.</p> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përshkruajë kuptimin e sipërmarrjes si aftësi;- të përshkruajë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve- të përshkruajë rolin e sipërmarrjes në kontekstin individual dhe shoqëror;- të përshkruajë veçoritë dhe rolin e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale;- të analizojë aftësitë dhe mundësitë personale në kontekstin e nismave sipërmarrëse;- të përshkruajë rëndësinë e sipërmarrjes në kontekstin individual dhe shoqëror;- të argumentojë me shembuj lidhjet dhe ndryshimet midis punës, profesionit dhe karrierës;- të shpjegojë kuptimin dhe rëndësinë e kualifikimit në përgjithësi dhe atij profesional, në lidhje me statusin e punësimit;- të diskutojë ndikimin e kualifikimit në zhvillimin e karrierës. <p>Instrumentat e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje - përgjigje me gojë dhe me shkrim- Vëzhgim me listë kontrolli	

RN 2 Nxënësi shpjegon koncepte të përgjithshme të tregut.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë problemin kryesor të ekonomisë;
- të përshkruajë veçoritë e sistemeve të ndryshme ekonomike;
- të përshkruajë konceptet kryesore të tregut si kërkesa dhe oferta, ekuilibri i tregut, elasticiteti i ofertës dhe kërkesës;
- të shpjegojë konceptet bazë të kostos, prodhimit, shitjes dhe lidhjet mes tyre;
- të dallojë strukturat e ndryshme të tregut, tiparet kryesore të tyre;
- të përshkruajë rolin ekonomik të firmave (sipërmarrjeve) dhe format ligjore të tyre;
- të shpjegojë rolin dhe rëndësinë ekonomike të konsumatorit në ekonominë e tregut;
- të shpjegojë mekanizmat e vendosjes së ekuilibrit në treg;
- të përshkruajë domosdoshmërinë e përshtatjes së veprimtarisë me kërkesat e tregut global;
- të evidentojë dallimin ndërmjet kostove fikse dhe kostove të ndryshueshme;
- të shpjegojë konceptet e konkurrencës dhe strukturës së tregut;
- të kryejë dallimin midis mikro dhe makroekonomisë
- të dallojë variablat makroekonomike;
- të kryejë dallimin dhe lidhjen midis produktit kombëtar bruto (PKB) dhe produktit të brendshëm bruto (PBB);
- të përshkruajë tregun valutor;
- të identifikojë faktorët që ndikojnë kursin e këmbimit;
- të përshkruajë natyrën e parasë, rolin e bankave dhe shërbimet që ato ofrojnë;
- të përshkruajë instrumentet që përdor banka;
- të shpjegojë konceptin e inflacionit, faktorët që ndikojnë në të, kostot që shkakton dhe lidhjen e tij me rritjen e shpejtë të parasë në qarkullim;
- të listojë elementët e hartimit të një buxheti;
- të përgatitë një buxhet të thjeshtë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi ndërton karrierën, skuadrën, performancën.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të shpjegojë kuptimin filozofik të kompanisë misionin dhe vizionin e saj në tregun e biznesit;
- të përshkruajë aktivitetet menaxhuese të sipërmarrësit;
- të evidentojë aftësitë themelore dhe teknikat për të udhëhequr dhe menaxhuar një biznes;
- të shpjegojnë funksionet dhe teknikat e menaxhimit

- të motivojë anëtarët e skuadrës;
- të planifikojë nevojat për burime njerëzore
- të rekrutojë burimeve njerëzore (personelit) sipas nevojave;
- të menaxhojë stafin, duke promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive të karrierës;
- të hartojë një plan efektiv veprimi sipas profilit përkatës;
- të rishikojë periodikisht objektivat dhe performancën;
- të monitorojë realizimin e objektivave për zhvillimin e karrierës në ndërmjetësimin e pasurive të paluajtshme;
- të vlerësojë rëndësinë e lidhshimit dhe përgjegjësisë në ndërtimin e një skuadre të suksesshme;
- të vlerësojë qëndrueshmërinë ekonomike për të ardhmen e kompanisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi demonstroi potencialin personal të ndërmjetësit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë interesat dhe dëshirat personale për profesione të ndryshme dhe kryesisht atë të ndërmjetësit;
- të argumentojë interesat dhe dëshirat personale për profesionin e përzgjedhur;
- të kryejë vetëvlerësimin duke mbajtur parasysh dëshirat dhe interesat që lidhen me profesionin e përzgjedhur;
- të vlerësojë/rivlerësojë aftësitë dhe prirjet personale të nevojshme në lidhje me profesionin e përzgjedhur;
- të shpjegojë me shembuj rëndësinë e komunikimit, veshjes, paraqitjes;
- të përzgjedhë format e ndryshme të sipërmarrjes në lidhje me synimet kryesore të karrierës personale, mundësitë dhe përfitimet në komunitet;
- të aplikojë aftësitë për planifikim dhe menaxhim projekti në situata të ndryshme;
- të hartojë një plan efektiv biznesi sipas profilit përkatës;
- të zbatojë fazat e menaxhimit të një projekti (duke identifikuar burimet e nevojshme për një projekt të veçantë);
- të improvizojë marrjen e vendimeve sipas dinamikave të veprimtarisë;
- të kryejë në mënyrë korrekte monitorimet e duhura;
- të vlerësojë ndjekjen e panairëve, ëorkshop-ëve, seminareve kombëtare dhe ndërkombëtare
- të vlerësojë ndjekjen e trajnimeve dhe të informohet për aplikimin e teknologjive të reja.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi themelon dhe organizon biznesin.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë formën juridike më të përshtatshme për ndërmarrjen, sipas mundësive të financimit dhe kërkesave të pronarëve
- të evidentojë kërkesat dhe kriteret e nevojshme për krijimin e biznesit;
- të plotësojë dokumentacionin për krijimin e biznesit, sipas formës juridike, duke shfrytëzuar burimet e duhura;
- të përcaktojë strukturën organizative të ndërmarrjes, sipas formës juridike të saj.
- të plotësojë saktë formularët e aplikimit;
- të përditësohet me dokumentacionin dhe kriteret e kërkuara për liçensimin si ndërmjetës i pasurive të paluajtshme;
- të liçensohet pranë organeve përkatëse, duke ndjekur afatet e licencimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin nxënësve

- Ky modul duhet të zhvillohet në klasë ose në biznes.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime mbi aftësitë sipërmarrëse të ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme, rolit dhe rëndësisë së sipërmarrjes, konceptet e përgjithshme të tregut, themelimit dhe organizimit të biznesit të ndërmjetësimit të pasurive të paluajtshme, si dhe ndërtimin e karrierës dhe performancës së duhur.
- Nxënësit (kursantët) duhet të angazhohen në studim individual të çështjeve teorike që trajtohen në modul si dhe në diskutime në grup në lidhje me aftësitë sipërmarrëse të ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme, rëndësisë së sipërmarrjes, koncepteve të përgjithshme të tregut, organizimin e një biznesi ndërmjetësues të pasurive të paluajtshme, karrierës dhe performancës së duhur.
- Mësuesi duhet të japë detyra individuale dhe në grup për të studiuar dhe analizuar tematikat e mësipërme.
- Nxënësit (kursantët) duhet të angazhohen sa më shumë të jetë e mundur në diskutimet dhe veprimtari konkrete që lidhen me aftësitë sipërmarrëse të ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme, rëndësisë së sipërmarrjes, koncepteve të përgjithshme të tregut, organizimit të një biznesi ndërmjetësues të pasurive të paluajtshme, karrierës dhe performancës së duhur që duhen ndërtuar.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve / kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit, të specifikuar për çdo rezultat të nxëni.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin e mësimin, të pajisur si më poshtë:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Kompjuter, fotokopje, shërbim interneti dhe programe kompjuterike për përdorimin e burimeve të informacionit për guida turistike
 - Manuale, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Ilustrime, filmime në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Etika profesionale dhe komunikimi”

Profili: Ndërmjetësim i pasurive të paluajjtshme

Niveli: V i KSHK

Viti: I

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	ETIKA PROFESIONALE DHE KOMUNIKIMI	M-17-1863-22
Qëllimi i modulit	Një modul teorik-praktik që i aftëson nxënësit të demonstrojnë profesionalizëm në formimin e figurës profesionale e personale, të zbatojnë rregullat dhe teknikat e komunikimit verbal dhe jo verbale, të komunikojnë me klientët sipas natyrës së tyre, si dhe të përdorin E-komunikimin në organizatë.	
Kohëzgjatja e modulit	100 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Individë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të përgjithshëm ose profesional	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi demonstroi profesionalizëm në formimin e figurës së tij profesionale e personale në organizatë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të zbatojë rregulloren e brendshme të organizatës;- demonstrojë veti pozitive personale (qetësia, vetë-kontrolli, gjakftohtësia, fleksibiliteti, shkalla e besim, të jetë iniciator dhe krijues);- të respektojë kodin e veshjes gjatë ushtrimit të profesionit;- të demonstrojë etikë profesionale duke respektuar orarin e punës, duke treguar siguri në kryerjen e punës, të demonstrojë besueshmëri e ndershmëri gjatë punës;- të ruajë sekretin profesional dhe informacionin konfidencial;- të zbatojë kurdoherë rregullat dhe protokollin e organizatës;- të analizojë sjelljen vetjake në biseda;- të jetë bashkëpunues i suksesshëm;- të demonstrojë gatishmërinë për të pranuar vërejtjet dhe për t'i shfrytëzuar ato në mënyrë konstruktive;- të demonstrojë përgjegjshmëri në punë;- të shfaqë aftësi kritike të menduarit për zgjidhjen e problemeve;- të punojë në grup për të përmirësuar cilësinë e punës;- të menaxhojë me profesionalizëm dhe korrektësi konfliktet në organizatë;- të demonstrojë aftësi për zgjidhjen e ankesave dhe mosmarrëveshjet me klientët, duke përdorur teknikat e	

-
- duhura sipas kodit të etikës;
 - të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe ruajtjes së mjedisit gjatë punës;
 - të vlerësojë shmangien e deklaratave të rreme ose keqinformuese në lidhje me ndërmjetësit e tjerë të pasurive të paluajtshme, bizneset e tyre ose praktikat e tyre të biznesit.
 - të vlerësojë shmangien e paraqitjes me dashje ose nga pakujdesia të ankesave të pabazuara ose të rreme ndaj kolegëve të tyre në lidhje me ështëje të etikës.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë.

Instrumentat e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 2 Nxënësi zbaton rregullat dhe teknikat e komunikimit verbal dhe jo verbale në organizatë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë rëndësinë e komunikimit të drejtpërdrejtë
- me klientët dhe bashkëpunëtorët;
- të përshkruajë rëndësinë e të qenurit të ndershëm dhe të vërtetë gjatë komunikimit, për ndërmjetësimin e pasurisë se paluajtshme;
- të përdorë teknikat e komunikimit verbal dhe jo verbal;
- të përdorë drejt tonalitetin e zërit, mënyrën e të folurit, artikulimin e drejtë për një komunikim efektiv;
- të përdorë gjuhën e trupit për transmetimin e mesazheve;
- të interpretojë sinjalet e gjuhës së trupit në komunikim;
- të zbatojë teknikat e të dëgjuarit aktiv;
- të përgatisë prezantime dhe të dallojë elementet e një prezantimi si: mjetet vizuale, emocionet, defektet, vëmëndjen;
- të vendosë dhe të arrijë qëllime gjatë prezantimeve;
- të ndërtojë fjali duke eliminuar gabimet retorike, stresin dhe tensionet.
- të kryejë biseda sqaruese dhe argumentuese;
- të bindë bashkëbiseduesit duke përdorur teknika të argumentimit;
- të zotërojë fjalor të pasur gjuhësor;
- të përdor terminologjinë e duhur, profesionale për një komunikim efektiv;
- të zbatojë rregullat e komunikimit me shkrim;
- të komunikojë në gjuhë të huaj kur nevojitet;
- të ndërtojë modele të ndryshme të komunikimit bazuar në raste dhe situata të ndryshme.
- të respektojë barazinë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare në komunikimin brenda dhe jashtë organizatës;

- të përdorë teknikat e frymëmarrjes, qetësimi, shtendosjes
- gjatë komunikimit duke eliminuar frymëmarrjen e gabuar, blackout;
- të ndërtojë modele të ndryshme të komunikimit bazuar në bazat e komunikimit;
- të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të telefonit në organizatë;
- të komunikojë me telefon në raste dhe situata të ndryshme duke respektuar teknikat e komunikimit me klientin;
- të përdorë retorikën në telefon sipas rregullave të parashikuara në organizatë;
- të demonstrojë aftësi në bërjen dhe marrjen e thirrjeve telefonike në mënyrë efektive;
- të zbatojë rregullat e komunikimit me klientët sipas hierarkisë profesionale;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Nxënësi komunikon me klientët, sipas natyrës së tyre.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të dallojë tipet e ndryshëm të klientëve gjatë komunikimit;
- të evidentojë arsyet që e shtyjnë klientin për të bërë një transaksion, në varësi të mundësive të tij ekonomike dhe klasës ose shtresës shoqërore;
- të zbatojë drejt mënyrën më të përshtatshme të komunikimit në vartësi të llojit të klientit dhe kërkesave të tij;
- të diskutojë, sipas rregullit, me klientin për kërkesat e tij;
- të krijojë klimë pozitive gjatë diskutimit me klientin;
- të përdorë gjuhën e trupit gjatë komunikimit me klientin;
- të përdorë drejt pyetjet në komunikim me klientin;
- të dëgjojë me vëmendje klientin;
- të kuptojë drejt dëshirat dhe nevojat e klientit;
- të komunikojë me tipe të ndryshëm klientësh:
 - klientin e rregullt;
 - klientin sqarues;
 - klientin e frikësuar;
 - klientin mendjemadh;
 - klientin e çuditshëm;
 - klientin e mistershëm;
 - klientin e dyshimtë- mosbesues;
 - klientin maniak;
 - klientin detyrues;
 - klientin me trauma;
 - klientin kreativ ;
 - etj
- të komunikojë me klientët me përgjegjshmërinë e duhur dhe me korrektësi.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Nxënësi përdor E–komunikimin në organizatë.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të shpjegojë rëndësinë e përdorimit “e-komunikimit” përmes mesazheve të platformave të biznesit të tilla si: email/posta-elektronike, faqet e internetit, mediat sociale, si dhe forma të tjera elektronike me shkrim në organizatë;
- të hapë dhe mbyllë sipas rregullit programet elektronike në kompjuter.
- të përgatisë mesazhe, konfirmime dhe njoftime për publikime në faqen e web-site të organizatës .
RN 5 Nxënësi përdor sistemin MIS.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të tregojë organizimin konkret të sistemit MIS;
- të demonstrojë hapat e marrjes së vendimit në sistemet e informacionit të menaxhimit MIS;
- të ndjekë skematikisht rrjedhën logjike të veprimeve që kryhen për të arritur në një konkluzion që mund të jetë një raport, skedulë apo kërkesë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të zhvillohet në klasë ose biznes.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime dhe demonstrime mbi përdorimin e pajisjeve, mjeteve, programeve bazë kompjuterike në punët e zyrës, si dhe aplikacioneve speciale dhe sistemeve TIK.
- Nxënësit (kursantët) duhet të angazhohen sa më shumë të jetë e mundur në diskutimet që lidhen me përdorimin e pajisjeve, mjeteve, programeve bazë kompjuterike në punët e zyrës, si dhe aplikacioneve speciale dhe sistemeve TIK.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet ti jepen detyra lidhur me përdorimin e pajisjeve, mjeteve, programeve bazë kompjuterike në punët e zyrës, si dhe aplikacioneve speciale dhe sistemeve TIK. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Mësuesi duhet të japë detyra individuale dhe në grup për të studiuar dhe analizuar tematikat e mësipërme.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve / kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe praktike

që parashikohen në këtë modul, në lidhje me përdorimin e pajisjeve, mjeteve, programeve bazë kompjuterike në punët e zyrës, si dhe aplikacioneve speciale dhe sistemeve TIK.

- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet plotësimi nga nxënësi i të gjitha kriterëve të realizimit të çdo rezultati mësimor të modulit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin e mësimit, të pasjisur si më poshtë:

- Klasë mësimore.
 - Postera ilustrues.
 - Kompjuter dhe projektor.
 - Pajisje, mjete dhe programe bazë kompjuterike në punët e zyrës.
 - Sistemet TIK (CRM, ERP, MIS).
 - Aplikacione specifike.
 - Materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

9. Moduli “Kërkimi dhe analiza e tregut në fushën e ndërmjetësimit”

Profili: Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme

Niveli: V i KSHK

Viti: II

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodit	KËRKIMI DHE ANALIZA E TREGUT NË FUSHËN E NDËRMJETËSIMIT	M-17-1869-22
Qëllimi i modulit	Një modul teorik-praktik që i aftëson nxënësit në përzgjedhjen e teknikës së përshtatshme të kërkimit në studimin e tregut imobilar, të realizimit të një studimi të thjeshtë të tregut imobilar dhe përpunimit të të dhënave të kërkimit.	
Kohëzgjatja e modulit	175 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Individë që kanë përfunduar me sukses vitin I në arsimin profesional për “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”.	
Rezultatet e të Nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi përzgjedh teknikën e përshtatshme të kërkimit në studimin e tregut imobilar. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të interpretojë drejt situatën aktuale në fushën e tregut imobilar për të cilën do të kryhet studimi;- të llogaritisë kostot e dhura për kryerjen e studimit ;- të llogarisë kohën e nevojshme për kryerjen e studimit;- të përzgjedhë teknikën e studimit të tregut, në përputhje me objektivat dhe specifikimet e kërkimit që do të kryhet.- të përzgjedhet metoda (një ose disa) kryesore dhe burimet e mbledhjes së të dhënave:<ul style="list-style-type: none">- intervistat personale (me anketim me pyetësorë, me telefon, me postë, me e-mail);- moderimi i diskutimeve në grupe të caktuara;- vëzhgimi i sjelljes së klientëve në treg (i drejtpërdrejtë ose i regjistruar);- informacione të marra on-line (p.sh., nga rrjetet sociale);- eksperimentimi (testimi) i ofrimit të produktit dhe dhe i sjelljes së klientëve;- mbledhja e të dhënave nga burimet zyrtare dhe jozyrtare (publikimet, interneti, televizioni, media e shkruar dhe elektronike etj.);- të përgatisë pyetësorët për mbledhjen e të dhënave;- të realizojë me kujdes dhe saktësi intervistimet;- të komunikojë me korrektësi;- të mbledhë të dhënat, me mënyra të ndryshme (sipas rastit).	

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi realizon një studim të thjeshtë të tregut imobilar.**Kriteret e vlerësimit:****Nxënësi duhet të jetë i aftë:**

- të përcaktojë segmentin e tregut, (target group- LIDS) që do të jenë objekt i studimit;
- të hartojë listat konkrete të detyrave që do të kryhen për realizimin e studimit;
- të grumbullojë informacion në hapësira të ndryshme të publikimit sipas llojit të transaksionit;
- të grumbullojë informacionin e duhur nga klientët ekzistues dhe nga rrjeti i kontakteve;
- të kontaktojë klientët dhe rrjetin e kontakteve sipas planit ditore dhe sipas manualit të procedurave në organizatë.
- të organizojë siç duhet takim me klientët potencialë sipas planit ditore;
- të përmbledhë informacionet e siguruar në pasqyra përmbledhëse krahasuese;

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi përpunon të dhënat e kërkimit.**Kriteret e vlerësimit:****Nxënësi duhet të jetë i aftë:**

- të administrojë të dhënat e mbledhura;
- të kryejë përpunimin paraprak i të dhënave duke i seleksionuar ato;
- të strukturojë të dhënat për të lehtësuar analizën e tyre;
- të realizojë kontrollin logjik të të dhënave;
- të kryejë kodimin e të dhënave;
- të hedhë të dhënat në kompjuter;
- të kryejë përpunimin statistikor të të dhënave, në kompjuter;
- të kryejë analizën përmbajtësore të të dhënave;
- të interpretojë rezultatet e hulumtimit;
- të përgatisë përfundimet dhe propozimet e hulumtimit;
- të prezantojë raportin e hulumtimit të tregut, për studimin e rastit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të zhvillohet në klasë ose biznes.
- Mësuesi duhet të zbatojë sa më shumë shembuj dhe demonstrime në përzgjedhjen e teknikës së përshtatshme të kërkimit në studimin e tregut imobilar, të realizimit të një studimi të thjeshtë të tregut imobilar dhe përpunimit të të dhënave të kërkimit.
- Kursantët duhet të angazhohen sa më shumë të jetë e mundur në

veprimtari praktike në lidhje me përzgjedhjen e teknikës së përshtatshme të kërkimit në studimin e tregut imobilar, të realizimit të një studimi të thjeshtë të tregut imobilar dhe përpunimit të të dhënave të kërkimit.

- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të synohet më tepër në verifikimin e koncepteve dhe shkallës së aftësive praktike që ata kanë fituar për të analizuar tregun në fushën e ndërmjetësimit
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet plotësimi nga nxënësi i të gjitha kriterëve të realizimit të çdo rezultati mësimor të modulit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin e mësimin, të pasjitur si më poshtë:

- Klasë mësimore.
 - Internet.
 - Kompjuter dhe projektor.
 - Materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

10. Moduli “Zhvillimi urban dhe teknika e ndërtimit”

Profili: Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme

Niveli: V i KSHK

Viti: II

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	ZHVILLIMI URBAN DHE TEKNIKA E NDËRTIMIT	M-17-1870-22
Qëllimi i modulit	Një modul teorik-praktik që i aftëson nxënësit të interpretojnë nocionet që lidhen me urbanistikën, me metodën e ndërtimit, projektin arkitektonik të objektit, si dhe të përshkruajnë çmimet e rifiniturave dhe koston e ndërtimit.	
Kohëzgjatja e modulit	150 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Individë që kanë përfunduar me sukses vitin I në arsimin profesional për “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi interpreton nocionet që lidhen me urbanistikën. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përshkruajë nocionin “urbanistika”- të tregojë detyrat që zgjidh urbanistika- të marrë informacionet e nevojshme në lidhje me zonimin funksional të qytetit, zonat e banimit- të marrë informacionet e nevojshme në lidhje me rrjetin rrugor të qyteteve dhe pikat e aksesit- të marrë informacionet e nevojshme në lidhje me planifikimin urban- të marrë informacionet e nevojshme në lidhje me pajisjen me leje zhvillimore, ndërtimi ose punimesh, bazuar në legjislacionin aktual.- të interpretojë anën teknike të legjislacionit lidhur me shfrytëzimin e mundshëm të pasurive të paluajtshme (distancat e lejuara, koeficientet e shfrytëzimit, strukturat e lejueshme, etj.)- të interpretojë dokumentet e nevojshme për leje zhvillimi dhe ndërtimi. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë dhe shkrim.- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>RN 2 Nxënësi interpreton karakteristikat kryesore të metodës së ndërtimit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p>	

- të dallojë materialet bazë që përdoren në:
 - a. Konstruksionin e ndërtesave
 - b. Izolimin e ndërtesave
 - c. Rifiniturat e ndërtesave
 - të interpretojë karakteristikat kryesore të materialeve të ndërtimit që përdoren në konstruksionet:
 - a. Me mur masiv: qerpici, guri, tullash dhe blloqesh
 - b. Moderne: Beton i armuar, metalike dhe druri
 - të interpretojë karakteristikat kryesore të materialeve që përdoren për izolimin e ndërtesave;
 - të interpretojë materialet dhe rifiniturat e përdorura;
 - të dallojë tipologjinë e objekteve sipas materialeve të përdorura në ndërtim;
 - të dallojë periudhat e ndërtimit sipas materialeve të përdorura në ndërtim;
 - të krahasojë rezistencen e materialeve të ndërtimit ndaj agjenteve atmosferike dhe ndaj kohës;
 - të shpjegojë ndërhyrjet e mundshme në objektet arkitektonike bazuar në materialet e përdorura në ndërtim
 - të shpjegojë rëndësinë e elementeve të sigurisë ndaj zjarrit;
- Instrumentet e vlerësimit:***
- Pyetje përgjigje me gojë e shkrim.
 - Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi interpreton projektin arkitektonik të objektit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të klasifikojë llojet e veprave arkitektonike
- të dallojë tipologjinë e objekteve sipas stilit arkitektonik
- të dallojë periudhat e ndërtimit sipas stilit arkitektonik
- të lexojë planimetrinë duke përfshirë:
 - a. tipologjinë e objektit,
 - b. shkallën,
 - c. dimensionimin,
 - d. zonimin,
 - e. orientimin,
 - f. skemën e ndarjes së ambienteve,
 - g. simbolet dhe dimensionet e mobilimit,
 - h. simbolet e konstruksionit,
 - i. simbolet elektrike,
 - j. simbolet hidrosanitare,
 - k. simbolet HVAC.
- të dallojë plotësimin e kriterëve në planimetri
- të dallojë nëse objekti plotëson normativat e:
 - a. ndriçimit natyral
 - b. hapësirës (siperfaqes) së ambienteve
 - c. kalimit ndërmjet ambienteve
 - d. pozicionimit të nyjeve hidrosanitare
 - e. pozicionimit të ambienteve të gatimit dhe ngrënies

- f. mobilimit
- g. zonimit ditor.
- të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të standardeve sipas manualit të projektimit dhe ndërtimit.
- të dallojë nëse objekti i përmbush këto standarde
- të shpjegojë preferencat e klientit tipik duke iu referuar:
 - a. organizimit të brendshëm të objektit,
 - b. orientimit hapësinor,
 - c. katit,
 - d. sipërfaqes,
 - e. numrit të njërive në kat,
 - f. diellëzimit,
 - g. pamjes së pandërprerë dhe perspektivës së pronave fqinjë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Nxënësi përshkruan çmimet e rifiniturave dhe koston e ndërtimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë koston mesatare të ndërtimit për njësi (m²) sipas llojit dhe cilësisë së objektit
- të përshkruajë çmimet për njësi të rifiniturave kryesore të aplikuara në objektet ndërtimore.
- të përshkruajë koston mesatare të rikonstruksionit të një apartamenti mesatar
- furnitorët kryesorë të materialeve të ndërtimit dhe çmimet e aplikuara prej tyre
- nënkontraktimi (furnizim+vendosje) dhe cmimet mesatare për m².

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë e shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të zhvillohet në klasë ose biznes.
- Mësuesi duhet të zbatojë sa më shumë shembuj dhe demonstrime gjatë interpretimit të nocioneve që lidhen me urbanistikën, me metodën e ndërtimit, projektin arkitektonik të objektit, si dhe të përshkrimit të çmimeve të rifiniturave dhe kostove të ndërtimit.
- Kursantët duhet të angazhohen sa më shumë të jetë e mundur në veprimtari praktike në lidhje me interpretimin e nocioneve që lidhen me urbanistikën, me metodën e ndërtimit, projektin arkitektonik të objektit, si dhe të përshkrimit të çmimeve të rifiniturave dhe kostove të ndërtimit.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të synohet më tepër në verifikimin e koncepteve dhe shkallës së aftësive praktike që ata kanë fituar për të analizuar tregun në fushën e ndërmjetësimit
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet plotësimi

nga nxënësi i të gjitha kriterëve të realizimit të çdo rezultati mësues të modulit

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin e mësimit, të pasjitur si më poshtë:

- Klasë mësimore.
- Internet.
- Kompjuter dhe projektor.
- Materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

11. Moduli “Vlerësimi financiar i pasurisë së paluajtshme”

Profili: Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme

Niveli: V i KSHK

Viti: II

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	VLERËSIMI FINANCIAR I PASURISË SË PALUAJTSHME	M-17-1871-22
Qëllimi i modulit	Një modul teorik-praktik që i njeh nxënësit me rëndësinë e vlerësimit financiar të pasurive të paluajtshme, parimet kryesore për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, si dhe i aftëson në zbatimin metodave të llogaritjes së vlerësimit të pasurisë së paluajtshme dhe përlllogaritjes së tatimeve dhe taksave e pasurisë së paluajtshme.	
Kohëzgjatja e modulit	175 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Individë që kanë përfunduar me sukses vitin I në arsimin profesional për “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi përshkruan rëndësinë e vlerësimit financiar të pasurive të paluajtshme. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të listojë metodat e ndryshme të vlerësimit të pasurisë së paluajtshme;- të dallojë hapat për zbatimin e secilës metode vlerësimi;- të listojë kriteret [parametrat] bazë të vlerësimit të pasurisë së paluajtshme:<ul style="list-style-type: none">- zona;- viti i ndërtimit të objektit;- sipërfaqja e pasurisë së paluajtshme:<ul style="list-style-type: none">- segmenti i sipërfaqes;- përqindja e sipërfaqes së përbashkët në raport me sipërfaqen totale;- rafinitura;- teknika e ndërtimit;- mundësia e zhvillimit të pasurisë;- të përshkruajë rëndësinë e përzgjedhjes së kriterëve për përcaktimin e vlerës së pasurisë së paluajtshme;- të përshkruajë rëndësinë e normës së kthimit të investimit të pasurisë së paluajtshme. Instrumentat e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Pyetje - përgjigje me gojë dhe me shkrim.- Vëzhgim me listë kontrolli	

RN 2 Nxënësi përshkruan parimet kryesore për vlerësimin e pasurive të paluajtshme.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë parimin e parashikimit;
- të përshkruajë parimin e zëvendësimit;
- të përshkruajë parimin e konkurrimit;
- të përshkruajë parimin e ofertës dhe kërkesës;
- të përshkruajë parimin e kontributit;
- të përshkruajë parimin e ndryshimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Nxënësi zbaton metodat e llogaritjes së vlerësimit të pasurisë së paluajtshme.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zbatojë matematikën financiare në vlerësimin e pasurisë së paluajtshme;
- të zbatojë metodën e krahasimit të drejtpërdrejtë
- të zbatojë metodën e investimit
- të zbatojë metodën e fitimit
- të zbatojë metodën e kostos
- të zbatojë metodën e zhvillimit (transformimit)
- të logarisë rentën virtuale, kostot në përdorim, shpenzimet dhe punimet e pasurisë së paluajtshme;
- të llogarisë vlerësimin e pasurisë për qelime huaje
- të llogarisë vlerësimin e pasurisë për qelime shpronësimi.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Nxënësi përlllogarit tatimet dhe taksat e pasurisë së paluajtshme.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të evidentojë detyrimet fiskale që rrjedhin nga aktiviteti me pasuritë e paluajtshme në rastin e:
 - a. përdorimit vetjak;
 - b. qirasë;
 - c. kalimit të së të drejtës së pronësisë nëpërmjet shitjes;
 - d. dhurimit;
 - e. trashëgimisë;
 - f. legalizimit;
 - g. burimeve të tjera.....
 - h. tarifave e shërbimeve për regjistrin e pasurisë, tarifave noteriale, etj.;
- të identifikojë çmimet e referencës në varësi zonës
- të përcaktojë bazën e tatueshme duke:

- a. përcaktuar vlerën dysHEME, sipas formës së përfitimit të pronësisë (psh rasti i privatizimit);
- b. përcaktuar fitimin kapital të realizuar;
- c. aplikuar korigjimin mbi kapitalin e realizuar sipas legjislacionit në fuqi;
- të llogarisë tatimin, bazuar në legjislacionin në fuqi;
- të evidentojë përfitimet që rrjedhin nga aplikimi i amnitive
- të evidentojë detyrimet fiskale që rrjedhin nga zotërimi / posedimi i pasurisë së paluajtshme
- të llogarisë detyrimet fiskale që rrjedhin nga zotërimi / posedimi i pasurisë së paluajtshme
- të llogarisë tarifat e shërbimit dhe ato shtetërore për kalimin e titullit të pronësisë:
 - a. Noteria
 - b. Kadastra Shtetërore

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të zhvillohet në klasë ose biznes.
- Mësuesi duhet të zbatojë sa më shumë shembuj dhe demonstrime gjatë vlerësimit financiar të pasurive të paluajtshme, Një modul teorik-praktik që i njeh nxënësit me rëndësinë e vlerësimit financiar të pasurive të paluajtshme, parimet kryesore për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, si dhe i aftëson në zbatimin metodave të llogaritjes së vlerësimit të pasurisë së paluajtshme dhe përlllogaritjes së tatimeve dhe taksave e pasurisë së paluajtshme.
- Kursantët duhet të angazhohen sa më shumë të jetë e mundur në veprimtari praktike në lidhje me zbatimin metodave të llogaritjes së vlerësimit të pasurisë së paluajtshme dhe përlllogaritjes së tatimeve dhe taksave të pasurisë së paluajtshme.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të synohet më tepër në verifikimin e koncepteve dhe shkallës së aftësive praktike që ata kanë fituar për të kryer vlerësimin financiar të pasurisë së paluajtshme në fushën e ndërmjetësimit;
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet plotësimi nga nxënësi i të gjitha kriterëve të realizimit të çdo rezultati mësimor të modulit

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin e mësim, të pasjisur si më poshtë:
- Klasë mësimore.
 - Internet, kompjuter dhe projektor.
 - Materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul
-

12. Moduli “Investimi në pasuritë e paluajtshme”

Profili: Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme

Niveli: V i KSHK

Viti: II

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	INVESTIMI NË PASURITË E PALUAJTSHME	M-17-1872-22
Qëllimi i modulit	Një modul teorik-praktik që i njeh nxënësit me alternativat e investimit të parasë, fokusin e investitorit të suksesshëm, si dhe i aftëson të intervistojë klientin dhe të planifikojë investimin në një pasuri të paluajtshme.	
Kohëzgjatja e modulit	150 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Individë që kanë përfunduar me sukses vitin I në arsimin profesional për “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Nxënësi përshkruan alternativat e investimit të parasë. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përshkruajë mundësitë alternative të investimit;- të përshkruajë kthimin e pritshëm për secilën prej mundësive alternative të investimit;- të përshkruajë avantazhet dhe disavantazhet për secilën prej mundësive alternative të investimit;- të krahasojë secilën prej alternativave të mësipërme me investimin në pasuritë e paluajtshme. <p>Instrumentat e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje - përgjigje me gojë dhe me shkrim.- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>RN 2 Nxënësi përshkruan fokusin e investitorit të suksesshëm. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përshkruajë kriteret për investimin në pasuritë e paluajtshme;- të përshkruajë termat e aplikuara për një investim të suksesshëm;- të përshkruajë rëndësinë dhe praktikat e ndjekura për ndërtimin e një rrjeti (network) të suksesshëm bashkëpunëtorësh;- të shpjegojë klishetë e gabuara që nuk e lejojnë një individ të jetë i suksesshëm në biznesin e investimit në pasuritë e paluajtshme. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.	

- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 3 Nxënësi interviston klientin.

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë një intervistë të gjatë dhe të detajuar me klientin në mënyrë që të përcaktojë:
 - a. buxhetin që klienti ka në dispozicion për investim;
 - b. mundësinë e financimit me kredi;
 - c. objektivat kryesore të klientit dhe raportin e tij me riskun;
 - d. afatet e investimit;
 - e. bashkë-vendimmarrësin/it;
 - f. kërkesa specifike të klientit;
- të përditësojë klientin me çmimet dhe ofertën aktuale në treg;
- të analizojë informacionin e mbledhur me qëllim kuptimin e kërkesave dhe motiveve të pashprehura nga klienti;
- të regjistrojë informacionin e mbledhur gjatë intervistës duke shtuar gjetjet e veta personale nga analizimi i informacionit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi planifikon investimin në një pasuri të paluajtshme.

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të interpretojë një plan amortizimi të kredisë me këste të barabarta dhe principal të barabartë;
- të llogarisë afatin për shlyerjen e kredisë, duke konsideruar të ardhurat e klientit dhe qiranë e pritshme të pasurisë;
- të hartojë një plan të thjeshtë 10 vjeçar investimi duke u bazuar në:
 - a. blerjen me financim bankar;
 - b. shlyerjen e kredisë;
 - c. vlerën e pritshme të pasurisë në fund të afatit 10 vjeçar.
- të hartojë një plan progresiv investimi për një periudhë 20 vjeçare (duke parashikur blerjen e disa pronave të shpërndara në kohë).

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 5 Nxënësi analizon objektivat e investitorit të suksesshëm.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë “modelin e vlerës neto”
- të identifikojë mënyrat më të mira të investimit, duke u kujdesur për

- a. manaxhimin e buxhetit personal
- b. rritjen e “Cash flow-t”;
- c. ndjekjen e vazhdueshme të vlerës neto të gjeneruar;
- të përcaktojë rrjetin e bashkëpunëtorëve që duhet të ndërtojë një investitor i suksesshëm;
- të analizojë modalitetet për blerjen.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të zhvillohet në klasë ose biznes.
- Mësuesi duhet të zbatojë sa më shumë shembuj dhe demonstrime të alternativave të investimit të parasë, të fokusit të investitorit të suksesshëm, si dhe i aftëson të intervistojë klientin dhe të planifikojë investimin në një pasuri të paluajtshme.
- Kursantët duhet të angazhohen sa më shumë të jetë e mundur në veprimtari praktike në lidhje me investimin e parasë, intervistimit të klientit dhe planifikimit për investim të një pasurie të paluajtshme.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të synohet më tepër në verifikimin e koncepteve dhe shkallës së aftësive praktike që ata kanë fituar për të kryer investime në pasuri të paluajtshme në fushën e ndërmjetësimit;
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet plotësimi nga nxënësi i të gjitha kriterëve të realizimit të çdo rezultati mësimor të modulit

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin e mësimit, të pasjitur si më poshtë:

- Klasë mësimore.
 - Internet.
 - Kompjuter dhe projektor.
 - Materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

VIII. Programi i përgjithshëm i praktikave profesionale në biznes

1. Programi i përgjithshëm i praktikës profesionale në biznes për vitin I

Kohëzgjatja: 20 ditë praktikë x 10 orë mësimore/ditë = 200 orë mësimore

Nr	Vendi i punës	Veprimtaritë	Kompetencat profesionale
1	Në agjenci ndërmjetësimi të pasurive të paluajtshme dhe në terren	Parapërgatitja për prospektim	<ul style="list-style-type: none"> Të përzgjedhë zonën e prospektimit. Të përgatisë materialet promocionale. Të përzgjedhë metodën që do të përdorë për prospektim. Të kryejë planifikim ditor për prospektimin që do të bëjë. Të zgjedhë objektet për prospektim.
2	Në terren	Prospektimi i zonës	<ul style="list-style-type: none"> Të kontaktojë me banorët, bizneset dhe administratorët e pallateve në zonë. Të grumbullojë kontaktet, informacionet dhe prospektet e nevojshme për zonën. Të shpërndajë materialet informuese dhe promovuese.
3	Në agjenci ndërmjetësimi të pasurive të paluajtshme	Përgatitja për prezantimin e një prone	<ul style="list-style-type: none"> Të përmbledhë avantazhet dhe disavantazhet e zonës. Të krahasojë çmimin e pronës me të ngjashmet e saj. Të evidentojë karakteristika të pronës që e bëjnë atë më të pëlqyeshme. Të japë zgjidhje për tipare të pronës që mund të kondiserohen të meta për blerësin konkret.
4	Në agjenci ndërmjetësimi të pasurive të paluajtshme	Regjistrimi i leads-ve (kontakteve) në sistem	<ul style="list-style-type: none"> Të regjistrojë gjeneralitetet dhe kontaktin e klientit potencial. Të regjistrojë kërkesat specifike të klientit potencial. Të regjistrojë burimin nga i cili ka ardhur klienti potencial.
5	Në agjenci ndërmjetësimi të pasurive të paluajtshme dhe në terren	Shpjegimi drejtuar klientit për përfitimet nga ndërmjetësimi	<ul style="list-style-type: none"> Të trajtojë pronën me çmimin aktual të tregut. Të caktojë kohën e finalizimit të transaksionit. Të shmangë problematikat që mund të ndodhin gjatë procesit të shitjes. Të ofrojë një inventar të pasur pronash dhe mundësi për të zgjedhur. Të kryejë një orientim profesional për procedurat juridike dhe financimin përmes

			ndërmjetësimit.
6	Në agjenci ndërmjetësimi të pasurive të paluajtshme	Regjistrimi i një Buyer Match (përshtatje e blerësit) në sistem	<ul style="list-style-type: none"> • Të regjistrojë segmentin e çmimit të kërkuar nga blerësi. • Të regjistrojë zonën ose zonat e kërkuar nga blerësi. • Të regjistrojë specifika të veçanta të kërkuara nga blerësi.
7	Në agjenci ndërmjetësimi të pasurive të paluajtshme	Hartimi i kontratës së ndërmjetësimit	<ul style="list-style-type: none"> • Të përcaktojë dokumentacionin e kërkuar për listimin. • Të mbledhë dokumentacionin e nevojshëm. • Të përcaktojë qartë gjeneralitet e palëve dhe objektin e kontratës. • Të përcaktojë çmimin dhe kushtet e veçanta (në rast se ka) të kontratës. • Të hartojë kontratën përfundimtare me klientin.
8	Në agjenci ndërmjetësimi të pasurive të paluajtshme	Rregjistrimi i pronës në sistem	<ul style="list-style-type: none"> • Të sistemojë dokumentacionin e pronës. • Të përgatisë një përshkrim të detajuar të pronës. • Të ngarkojë (aplodojë) në sistem dokumentacionin (foto, informacion për pronën) e klientit. • Të plotësojë fushat përkatëse të sistemit me informacionin e kërkuar. • Të finalizojë regjistrimin e pronës në sistem.
9	Në agjenci ndërmjetësimi të pasurive të paluajtshme	Hartimi i planeve të punës	<ul style="list-style-type: none"> • Të përcaktojë objektivat profesionale (afatmesme & afatgjata) dhe financiare. • Të përcaktojë veprimtaritë që nevojshme ditore dhe volumin e tyre. • Të përcaktojë afatet kohore për kryerjen e veprimtarive. • Të finalizojë planet ditore, javore, mujore dhe vjetore.
10	Në terren	Organizimi i “Open house”	<ul style="list-style-type: none"> • Të përzgjedhë mjedisin e përshtatshëm. • Të përgatisë mjedisin. • Të përgatisë materiale promovuese. • Të organizojë një event dixhital. • Të përgatisë një mini pritje (mini koktejl). • Të mirëpresë të ftuarit.
11	Në agjenci ndërmjetësimi të pasurive të paluajtshme	Realizimi i telefonatave të ftohta me persona të rastësishëm	<ul style="list-style-type: none"> • Të përzgjedhë database për kryerjen e telefonatave. • Të përdorë skriptet e gatshme të kompanisë. • Të kryejë lojë me rolë me kolegët për telefonatat e ftohta. • Të realizojë telefonata konkrete. • Të vendosë takime me klientët pas

			telefonatave.
Rekomandohet që 14 ditë praktikë të kryhen në Agjenci dhe 6 ditë praktikë të kryhen në terren			

2. Programi i përgjithshëm i Praktikës profesionale në biznes për vitin II

Kohëzgjatja: 20 ditë praktikë x 10 orë mësimore/ditë = 200 orë mësimore

Nr	Vendi i punës	Veprimtaritë	Kompetencat profesionale
1	Në agjenci ndërmjetësimi të pasurive të paluajtshme	Përshtatja e një KIP-i (kontratë individuale pune)	<ul style="list-style-type: none"> Të përcaktojë qartë gjeneralitetet e palëve. Të përcaktojë objektin e kontratës. Të saktësojë pagën dhe kushtet e veçanta të punës.
2	Në agjenci ndërmjetësimi të pasurive të paluajtshme	Hartimi i kontratës së kaparit	<ul style="list-style-type: none"> Të përcaktojë qartë gjeneralitetet e palëve. Të përcaktojë objektin e kontratës. Të saktësojë kushte të veçanta të kërkuara nga palët. Të saktësojë afatet e dakortësuara në kontratë.
3	Në agjenci ndërmjetësimi të pasurive të paluajtshme	Përgatitja e broshurës për prezantimin e pronës	<ul style="list-style-type: none"> Të mbledhë informacionin mbi pronën. Të përzgjedhë fotot e pronës. Të përcaktojë formatin digjital apo të printuar. Të përcaktojë kanalet e shpërndarjes së broshurës. Të hartojë plan pune për shpërndarjen e broshurave.
4	Në agjenci ndërmjetësimi të pasurive të paluajtshme	Përgatitja e analizës krahasuese të tregut (CMA=comparative market analyses)	<ul style="list-style-type: none"> Të përcaktojë zonën. Të përcaktojë segmentin e çmimit. Të përcaktojë karakteristika të veçanta të zonës nëse ka. Të evidentojë inventarin e pronave në zonë. Të evidentojë pronat e shitura në zonë. Të prezantojë vizualisht CMA.
5	Në agjenci ndërmjetësimi të pasurive të paluajtshme dhe në terren	Negocimi i çmimit të pronës	<ul style="list-style-type: none"> Të mbështetet te të dhënat e CMA-së. Të llogarisë kohën mesatare të shitjes së pronave të ngjashme. Të krahasojë pronën konkrete me pronën mesatare në zonë. Të llogarisë çmimin e sugjeruar të pronës me qëllim shitjen e saj në kohën e kërkuar nga klienti.
Rekomandohet që 12 ditë praktikë të kryhen në Agjenci dhe 8 ditë praktikë të kryhen në terren			